



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT SHKODER

Nr.35/1prot.

Shkodër, më 16.01.2023

LËNDA: Mbi vendimin Nr.95 datë 23.12.2022 të Këshillit të Bashkisë Vau-Dejës.

KESHILLI BASHKIAK VAU-DEJËS

Prefekti i Qarkut Shkodër në zbatim të kompetencave që i jep ligji nr.107/2016 dt.2.10.2016 "Për Prefektin", neni 56 KPAD, Urdhërit të Kryeministrit Nr.50, datë 12.04.2017 "Për miratimin e detyrave të administratës së Prefektit të Qarkut", neni 5, Urdhërit të Ministrit të Brendshëm Nr.175 dt.9.07.2020 "Për miratimin e rregullores së Brendshme "Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut"si dhe aneksi 1 "Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollit nga Prefekti i Qarkut", Kreu II, neni 4, në mbështetje të nenit 9, pika 1/1.2 germa a dhe c, neni 27 pika 5, neni 64/c të Ligjit Nr.139/2015 datë 17.12.2015 për "Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar, Ligjit Nr.57/2020 "Për pyjet", VKM Nr.433 datë 08.06.2016 "Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të Ish-komunave/bashkive" i ndryshuar, shtojcës nr.47, VKM Nr.1353, datë 10.10.2008 "Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvoglimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor" pika 5/ç, materialit të dërguar nga sekretari i këshillit bashkiak Vau-Dejës Nr.1.prot datë 4.01.2023 dokumentacioni shoqërues i mbledhjes së këshillit bashkiak Vau-Dejës të datës 23.12.2022", shqyrtoi **VKB Nr.95, datë 23.12.2022 Vau-Dejës** "Miratimin me shkrim për vazhdimin e procedurave të heqjes nga fondi pyjor të sipërfaqes prej 0.2 ha në ngastrën nr.12 në ekonominë pyjore Drin Gjadër Kir".

Së pari, referuar Urdhërit të Ministrit të Brendshëm Nr.175, datë 9.07.2020 "Për miratimin e rregullores së Brendshme "Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut", Aneksi 1 "Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollit nga Prefekti i Qarkut", Kreu II, neni 4, germa b, pika v, shprehet se akti i depozituar duhet detyrimisht të shoqërohet nga dokumentet e mëposhtëm Çertifikatën e pronësisë ose në mungesë të saj statusin juridik nga ASHK-ja,

Së dyti, ju i jeni referuar VKM Nr.1353, datë 10.10.2008 "Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor", akt nënligjor në zbatim të ligjit të shfuqizuar Nr.9385/2005, por jo e përcaktuar nga ju referenca e saktë/plotë ligjore siç është neni 17. Kjo dispozitë nuk përfshin aktivitetin që ju keni miratuar,

Për sa trajtuar, Prefekti kërkon plotësim të dokumentacionit.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin, .

PREFEKTI

Majlinda ANÇONI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I BASHKISË

V E N D I M

Nr. 95, datë 23.12.2022



**Për miratimin me shkrim për vazhdimim e procedurave të heqies nga fondi pyjor të një sipërfaqe prej 0.2 ha në ngastren nr 12 ekonomia pyjore Gjader Kir.**

Këshilli Bashkiak Vau Dejës në mbledhjen e tij të datës 23.12.2022, dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë Vau Dejës, mbështetur në nenin 9 pika 1.2, nenin 27 pika 5, nenin 54 të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, pika 49 e VKM nr. 433 datë 08.06.2016, i ndryshuar “Për transferimin në pronësi të bashkive pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventareve, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive” ;Ligjit 57/2020,date 30.04.2020 “Për Pyjet”,neni 5; VKM nr 591,datë 09.10.2018 “Për disa ndryshime në VKM nr.1353,datë 10.10.2008 “Për përcaktimin e rregullave për paraqitjen e kërkesës,mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik ,si dhe të kriterëve e të procedurave të zvoglimit të sipërfaqes e vëllimit të fondit pyjor”të ndryshuar pika 2,shkronja ç, *me shumicë votash.*

V E N D O S I:

- 1) Miratimin me shkrim për vazhdimim e procedurave të heqies nga fondi pyjor të një sipërfaqe prej 0.2 ha në ngastrëen nr 12 ekonomia pyjore Drin Gjader Kir.
- 2) Ngarkohen Drejtoria e Pyjeve,Turizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.
- 3) Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”).

**K R Y E T A R**

**Mark Bisha**



Sekretari i Këshillit Bashkiak

**Ardian Çelepija**

Miratuar me 20 vota

Vota Pro 20

Vota Kundër -

Vota Abstenim -

Zbardhur me datë 30.12.2022